



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:041184

Datë: 16.10.2024

Numri i dokumentit: 06302212

PKR.nr.91/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga trupi gjykues prej tre gjyqtarëve profesionistë, përkatësisht gjyqtari Naser Foniqi – kryetar i trupit gjykues dhe Fatime Dërmaku e Ertan Sejfulla - anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita Hoxha Koleci, në çështjen penale të akuzuarve L.Xh. e E.H., për shkak se secili veç e veç kanë kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269, par. 1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK, ndërsa i akuzuari L.Xh. edhe për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.27/2024, të datës 15.04.2024, pas shqyrtimit fillestar të datës 25.04.2024 dhe shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, të mbajtur më datat 10.06.2024, 12.09.2024 dhe 08.10.2024, në të cilin kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Dulina Hamiti dhe të akuzuarit L.Xh. e E.H., me mbrojtësit e tyre avokatët Shkëlzen Behrami Bajram Sherifi, me autorizim, me datë 10.10.2024, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I.

Të akuzuarit:

L.Xh., i biri i B. dhe I., e vajzërisë A., i lindur me datë ... në Prishtinë, rr. "...", Prishtina ..., O..., kati ... pa të dhëna të tjera, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar- në marrëdhënie jashtëmartesore, pa fëmijë, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë nën masën e paraburgimit prej datës 02.02.2024 deri me datë 31.05.2024, nga e cila datë ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak deri me datë 02.07.2024, dhe

E.H., i biri i H. dhe R., e vajzërisë K., i lindur me datë ..., në Prishtinë, lagja ..., rr. "...", Hyrja ..., nr..., me numër personal ..., student ne fakultetin e shkencave kompjuterike, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë nën masën e paraburgimit prej datës 02.02.2024 deri me datë 31.05.2024, nga e cila datë ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak deri me datë 02.07.2024,

Konform nenit 364 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale – në vijim KPP

JANË FAJTORË

S e p s e: me datë 02.02.2024 rreth orës 20:40, në ..., Rr. "...", të pandehurit L.Xh. dhe E.H., pa autorizim kanë poseduar substanca narkotike, psikotrope dhe analoge të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, ashtu që, gjatë operacionit të policisë - Njësia DHTN-në Prishtinë, në Rr. "...", në Lagjen ... në Prishtinë, i kanë ndaluar të pandehurit L. dhe E., me ç'rast, gjatë kontrollit në trupin e të pandehurit E. kanë gjetur 7 qese me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 9.1 gram, ndërsa gjatë kontrollit në banesën e të pandehurit L.Xh., gjatë kontrollit nga policia janë gjetur 7 qese me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 9.1 gram, 2 qese me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 30.6 gram, një peshore digjitale, 1 pako foli e mbushur me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 11 gram, një peshore digjitale, 2 mulli (grinder) për bluarje të substancës narkotike marihuanë, pastaj substancat narkotike dhe sendet tjera të përshkruara si më lart janë sekuestruar nga policia,-

- me këto veprime, secili veç e veç kanë kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269, par. 1 të KPRK.

II

Konform nenit 364 të KPP i akuzuari L.Xh., me të dhëna personale si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi,

ËSHTË FAJTOR

S e p s e: i akuzuari L.Xh. me datë 02.02.2024, në banesën e tij në Prishtinë, lagja ..., Rruga "...", në kundërshtim me Ligjin nr. 05/L -022 për Armë, me dashje ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar revolen e tipit "Blow Mini Mod 2003" dhe dy fishekë, e cila i është gjetur dhe sekuestruar nga Policia e Kosovës,-

- me këto veprime, ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366, par. 1 të KPRK.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 38; 42; 43; 69; 269 par. 1 e 3 dhe 366 par. 1 e 3 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale – në vijim KPP, të akuzuarve L.Xh. e E.H., secilit veç e veç iu shqipton:

DËNIM ME GJOBË DHE ME BURGIM

Të akuzuarit L.Xh. i shqipton:

- **Dënim me gjobë në shumë prej njëmijë (1000) €, dhe**
- **Dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti,** për veprën penale Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269, par. 1 të KPRK, si dhe
- **Dënim me gjobë në shumë prej njëmijë (1000) €,** për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366, par. 1 të KPRK,
- Ndërsa, të akuzuarit E.H. i shqipton:

- **Dënim me gjobë në shumë prej pesëqind (500) €, dhe**
- **Dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (një) viti**, për veprën penale Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269, par. 1 të KPRK.
- Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata do t'iu caktoj të dënuarve si më lart një ditë burgimi për 20 € të gjobës
- Dënimet si më lart do të ekzekutohen pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.
- Dënimet me gjobë si më lart, të akuzuarit mund t'i paguajnë deri në tri këste.
- Në dënimin e shqiptuar, të akuzuarve i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës 02.02.2024 deri me datë 31.05.2024 dhe ajo e arrestit shtëpia prej 31.05.2024 deri me datë 02.07.2024.
- Detyrohen të akuzuarit që **secili veç e veç** t'i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, **ndërsa në emër të paushallit gjyqësor duhet të paguajnë shumën prej njëqind (100) € dhe pesëdhjetë (50) € në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit**, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- **Nga të akuzuarit konfiskohen dhe shkatërrohen** sasia e narkotikut të llojit në peshë të përgjithshme prej 47.03 gram, një revole e tipit “Blow Mini Mod 2003” me dy fishekë, dy peshore digjitale dhe një mulli grinder për bluarjen e substancës narkotike, të gjitha të përdorura për kryerjen e veprës penale.
- Të akuzuarit L.Xh. i kthehen paratë e gatshme në vlerë prej 710 euro, ndërsa të akuzuarit E.H. i kthehen paratë e gatshme në vlerë prej 340 euro dhe telefoni i tipit Iphone 14 Pro Max, pasi nuk është vërtetuar se janë përdorur për kryerjen e veprës penale apo përfituar me kryerjen e veprës penale.

ARSYETIMI

Pas kallëzimit penal të Policisë së Kosovës/Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë, Sektori Rajonal në Prishtinë DPP DKKO / DHTN në Prishtinë, R-2024-XI-DKKO-HTN-PR-21, të datës 03.02.2024, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.27/2024, të datës 15.04.2024, ndaj të akuzuarve L.Xh. e E.H., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK; O.K. e A.E., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK, dhe L.Xh. edhe për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 25.04.2024, të akuzuarit O.K. e A.E. janë deklaruar fajtorë për veprën penale si në pikën I të aktakuzës, ndërsa të akuzuari L.Xh. e E.H. kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe janë deklaruar të pafajshëm për veprën penale

për të cilën është akuzuar, ndërsa i akuzuari Xh. është deklaruar fajtorë për veprën penale si në pikën III të aktakuzës.

Meqenëse të akuzuarit O.K. e A.E. e kanë pranuar fajësinë dhe shpallja e aktgjykimit është paraparë të bëhet të njëjtën ditë, si dhe për arsye të efikasitetit të përfundimit të procedurës penale ndaj këtyre të akuzuarve, përkatësisht me qëllim të një gjykimi të drejtë dhe në një afat sa më të shkurtër të paraparë me dispozitat ligjore në fuqi dhe konventës evropiane për të drejtat e njeriut, gjykata ka vendosur ta veçoj procedurën penale ndaj të akuzuarve L.Xh. e E.H..

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, në fjalën e tij hyrëse prokurori i shtetit ka deklaruar se aktakuza ngritur nga prokuroria mbështetet në prova të mjaftueshme të cilat i ka propozuar në aktakuzë që të administrohen, siç janë: Raporti informues për konfirmim të bastisjes me numër të rastit R-2024-XI-DKKO-HTN-PR-21 i datës 03.02.2024 nga Policia e Kosovës- DHTN-DKKO-Prishtinë; Procesverbali për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm me numër rasti R-2024-XI-DKKO-HTN-PR-21 i datës 02.02.2024; Vërtetimet mbi sekuestrimin e provave apo të pasurisë me numër rasti R-2024-XI-DKKO-HTN-PR-21 i datës 02.02.2024; Fotoalbumi nga Njësia e Forenzikës lidhur me numrin e rastit R-2024-XI-DKKO-HTN-PR-21 i datës 02.02.2024; Raporti i ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë numër AKF/2024-0900/24 – 855, i datës 26.03.2024; dhe Raporti i ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë numër AKF/2024-1012/24 – 967, i datës 25.03.2024, me administrimin e të cilave do të vërtetohet se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar. Në fjalën përfundimtare, prokurori i shtetit ka theksuar se nga administrimi i provave dhe dëshmimeve gjatë shqyrtimit gjyqësor, në mënyrë të plotë është vërtetuar se të akuzuarit Xh. dhe H., në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, ndërsa i akuzuari L.Xh. ka kryer edhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK, e kjo vërtetohet nga administrimi i provave materiale të paraqitura në fjalën hyrëse, me administrim e të cilave është vërtetuar se të akuzuarit si më lart kanë kryer veprat penale si në aktakuzë, duke theksuar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe i ka propozuar gjykatës që të pandehurit si më lart t'i shpallë fajtorë dhe t'i dënoj sipas ligjit, e po ashtu ka mbetur pranë propozimit në aktakuzë për konfiskimin e sendeve.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.Xh., av. Shkelzen Behrami, në fjalën hyrëse ka deklaruar se i gjithë boshti i aktakuzës është i mbështetur në fakte dhe prova të cilat nuk e plotësojnë standardin ligjor për tu ngritur një akt akuzues, pasi prokuroria duke vepruar në mënyrë tërësisht të njëanshme ka bërë sigurimin dhe keqinterpretimin e provave gjatë bastisjes së zhvilluar në banesën e prindërve të pandehurit L.Xh., duke shtuar se provat të cilat i vihen në barrë të pandehurit dhe jo provat të cilat mund të trajtojnë më objektivisht këtë proces, andaj konsideron se nga provat personale dhe materiale të cilat janë objekt i trajtimit në këtë çështje gjyqësore, në mënyrë të pa shmangshme do të pasqyrohet pafajësia e të mbrojturit të tij, duke theksuar se aktakuza nga fillimi ka qenë me të meta juridike, e kthyer në plotësim nga gjykata, por në asnjë mënyrë nuk ka arritur t'i veçoj veprimet e të pandehurve në kryerjen e veprës, dhe se te i pandehuri L.Xh. në asnjë mënyrë nuk ka arritur të definoj, qartësoj, portretizoj veprën penale që i vihet në barrë ngase prokuroria nuk ka ofruar prova personale apo materiale të besueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar. Pastaj, mbrojtësi Behrami ka theksuar se prokuroria pretendon se i pandehuri L.Xh. e shfrytëzonte banesën me bashkë të pandehurin tjetër si një vend për kryerjen e aktiviteteve kriminale, derisa është e qartë edhe në raportin e bastisjes ku janë vërtetuar edhe personat prezentë në atë banesë, e ku figuron se aty është gjendur babai, nëna dhe motra e të pandehurit L.Xh., i cili ia ka bërë të qartë gjykatës se nuk jeton në këtë banesë, andaj

në këto rrethana konsideron se nga provat dhe faktet që do të administrohen gjatë shqyrtimit gjyqësor, do të konstatohet pafajësia e plotë e të mbrojturit të tij. Ndërsa, në fjalën përfundimtare të përgatitur me shkrim, mbrojtësi Behrami ka theksuar se pas analizimit, trajtimit dhe shqyrtimit të fakteve dhe provave është vërtetuar pafajësia për pikën I të akuzës pasi me asnjë provë personale apo materiale nuk është konstatuar se i pandehuri L.Xh. ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitje e paautorizuar e narkotikeve substancave psikotrope dhe analoge, e për këtë gjykata paraprakisht duhet ta evidentoj faktin se për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementeve të saj, në referim të veprave penale të cilat iu vihen në barrë të akuzuarve, duke theksuar se vërehet një paqartësi, në përshkrim të veprimeve inkriminuese të ndërmarra nga të akuzuarit, pasi në dispozitivin e aktakuzës përshkruhet si në vijim: ...pa autorizim kanë blerë apo poseduar me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofruar për shitje substance apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë...”, për këtë nuk janë konkretizuar veprimet inkriminuese, të cilat pretendohen se ishin ndërmarrë nga të akuzuarit, por ishin përshkruar vetëm format që i parasheh dispozita e nenit 267 par. 1 të KPRK, por nga provat e administruara nuk është provuar asnjëra nga format. Po ashtu, mbrojtësi Behrami ka thënë se sipas aktakuzës pretendohet se të akuzuarit L.Xh. dhe E.H. kishin kryer veprën penale, në bashkëkryerje, por për të ardhur në shprehje bashkëkryerja si një nga format e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale, duhet të konkretizohen veprimet inkriminuese të akuzuarve L.Xh. dhe E.H., e që këto veprime përgjatë procesit gjyqësor nuk janë argumentuar e aq më pak konkretizuar nga prokuroria, duke shtuar se nuk ekziston dyshimi i bazuar në prova se i mbrojturi i tij ka qenë i përfshirë në këtë rast, pasi i pandehuri L.Xh. nuk jeton në banesën ku ka ndodhur bastisja, i njëjti tashmë është duke bashkëjetuar me znj. Q.G. nga muaji korrik 2023, e kjo dëshmohet përmes kontratës së qirasë së banesës, ndërsa duke iu referuar provave materiale, përkatësisht foto Albumit i siguruar nga Njësia e Forenzikës së Policisë së Kosovës, ku ishte evidentuar substanca narkotike si dhe vendet ku janë gjetur dhe asnjë prej tyre nuk është sekuestruar apo gjetur te i pandehuri L.Xh., pastaj në deklaratën e dhënë në prokurori dhe para trupit gjykues, i bashkëpandehuri E.H. ka konfirmuar se sasia prej 30 gram marihuanë ishte e tij dhe se 14 qese me marihuanë në peshë prej 18.2 gram ishin gjetur te ai, ndërsa deklarata e të pandehurit L.Xh. ishte marrë në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale, neni 209 KPP, kur gjatë marrjes në pyetje të njëjtit i ishte mohuar e drejta e qasjes në shkresat e lëndës dhe se kjo deklaratë është provë e pa pranueshme e cila është evidentuar edhe në procesverbalin e marrjes në pyetje të datës 21.02.2024 në prokurori. mbrojtësi Behrami ka thënë se sendet e ngarkuara te i pandehuri L.Xh. nuk ishin gjetur te ai por te një hapësirë në dhomën e gjumit e cila shfrytëzohej nga vëllai i tij, i cili jeton në atë banesë dhe se ndaj të njëjtit është duke u zhvilluar procedura në departamentin për të mitur, duke shtuar se kërkon kthimin e sendeve dhe atë shumën prej 710 (shtatë qind e dhjetë) euro, të cilat janë sekuestruar sipas urdhrin përfundimtar, pasi nuk është provuar se të njëjtat janë dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale, e pastaj ka kërkuar nga gjykata që ndaj të mbrojturit të tij, për pikën I të aktakuzës të merr aktgjykim lirues, ndërsa për pikën III të aktakuzës, për veprën penale nga neni 366 par. 1 të KPRK, pasi që i mbrojturi i tij ka pranuar fajësinë, gjatë shqiptimit të dënimit të ketë parasysh pranimin e fajësisë në stadin fillestar të procedurës si rrethanë lehtësuese, kërkim faljen në prani të gjykatës dhe faktin se i njëjti nuk është përsëritës apo recidivist i asnjë vepre penale, nuk ka të kaluar kriminale dhe është i gjendjes se dobët ekonomike.

I akuzuari L.Xh. në fjalën hyrëse ka thënë se mbështet fjalët e mbrojtësit të tij. Ndërsa në fjalën përfundimtare, i akuzuari L.Xh. ka theksuar se e ka dëgjuar fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, e ka mbështetur në tërësi të njëjtën dhe për pikën III të aktakuzës kërkon dënim më të butë, ndërsa për pikën I të aktakuzës është deklaruar prapë i pafajshëm, duke shtuar se për narkotikun për të cilin akuzohet është hapur një procedurë penale për të mitur ndaj vëllait të tij të mitur, T. Xh.

Në fjalën hyrëse, mbrojtësi i të akuzuarit E.H., av. Bajram Sherifi ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata do të vërtetoj se nga provat e bashkangjitura, nga dëshmitarët apo të akuzuarit të cilët kanë deklaruar në prokurori dhe polici, do të vërtetohet se i mbrojturi i tij asnjëherë nuk ka kryer shitjen e substancave narkotike, i njëjti ka pranuar se ka pasur në posedim substancën por asnjëherë nuk ka kryer shitje, gjë e cila nuk është vërtetuar nga ana e prokurorisë pasi nuk kemi asnjë dëshmi apo dëshmitarë që do të vërtetoj se ai ka kryer shitjen e këtyre substancave, e as që ka kryer ndonjë veprë penale në bashkëkryerje me të akuzuarin L.Xh.. Ndërsa, në fjalën përfundimtare të përgatitur me shkrim, mbrojtësi ka theksuar se pas dëgjimit të pandehurve dhe pas paraqitjes së provave nga prokuroria është vërtetuar se i mbrojturi i tij i cili akuzohej se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale si në dispozitiv të aktakuzës, po ashtu ka thënë se i mbrojturi i tij asnjëherë nuk e ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet mirëpo maksimumi mund të kishte elemente të veprës penale nga neni 269 par.1 të KPRK, e për këtë, qysh nga faza e hetimeve kishte shfaqur gatishmëri për të arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë. Pastaj, mbrojtësi Sherifi ka shtuar se prokuroria nuk ka ofruar prova sa i përket shitjes së narkotikëve por vetëm sa i përket konsumimit, pasi në Komentarin e Kodit të Procedurës Penale shpjegohet se deri te vepra penale nga neni 267 par. 1 të KPRK nuk mund të vijë nëse nuk dëshmohet se i akuzuari ka kryer shitjen e narkotikut, e po ashtu, mbrojtësi i është referuar aktgjykimit PRK.nr.47/2024 si rast nga praktika gjyqësore i ngjashëm me rastin në fjalë ku ishte bërë rikualifikimi i veprës penale. Po ashtu, mbrojtësi Sherifi i ka propozuar gjykatës që mjetet monetare prej 340 euro dhe telefoni Iphone 14 t'i kthehen të mbrojturit të tij pasi që të njëjtat nuk rezultojnë si rezultat i veprës penale.

I akuzuari E.H. në fjalën hyrëse ka thënë se mbështes fjalët e mbrojtësit të tij. Ndërsa në fjalën përfundimtare, i akuzuari E.H. ka theksuar se ka dëgjuar fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe e mbështetë në tërësi të njëjtën.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor janë administruar provat materiale të propozuara nga prokuroria në aktakuzë dhe të akuzuarit kanë dhënë mbrojtjen e tyre, e të paraqitura si në vijim:

- Raporti informues për konfirmim të bastisjes me numër të rastit R-2024-XI-DKKO-HTN-PR-21 i datës 03.02.2024 nga Policia e Kosovës- DHTN-DKKO-Prishtinë;
- Procesverbali për kontrollin dhe sekuestrim të përkohshëm me numër të rastit i R-2024-XI-DKKO-HTN-PR-21 të datës 02.02.2024 nga Policia e Kosovës- DHTN-DKKO-Prishtinë;
- Vërtetimet mbi sekuestrimin e provave apo të pasurisë me numër të rastit R-2024-XI-DKKO-HTN-PR-21 i datës 02.02.2024 nga Policia e Kosovës- DHTN-DKKO-Prishtinë;
- Fotoalbumi nga Njësia e Forenzikës lidhur me numrin e rastit me numër të rastit R-2024-XI-DKKO-HTN-PR-21 i datës 02.02.2024;
- Raporti i ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me numër AKF/2024- 0900/24 – 855, i datës 26.03.2024;
- Raporti i ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me numër AKF/2024- 1012/24 – 967, i datës 25.03.2024; dhe

- Raporti i ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me numër AKF/2024- 0098 i datës 26.03.2024, me të cilin nga telefoni i të pandehurit E.H. janë nxjerr disa fotografi në të cilat shihen substancat narkotike, të cilat përkojnë me përshkrimin e pikës I të aktakuzës pasi te i akuzuari H. janë gjetur 7 qese me substancë narkotike të llojit marihuanë.

Pas njoftimit me të drejtat e tij të parapara me nenin 344 të KPP, se ka të drejtë të mos deklarohet, e nëse zgjedh të deklarohet marrja e tij në pyetje do të zbatohet në pajtim me paragrafët 2 dhe 4 të këtij neni, i akuzuari L.Xh. ka shfrytëzuar të drejtën e tij për të deklaruar dhe në pyetje nga mbrojtësi i tij ka thënë se me datë 02.02.2024, ka qenë me të fejuarën e tij në restorant, dhe aty në telefon e kanë thirrur prindërit e tij, të cilët e kanë ftuar për darkë, pastaj ai është nisur për te ata, por gjatë rrugës, te “A...”, afër banesës së tij është takuar me E., me të cilin kanë shkuar në banesën ku jetojnë prindërit e tij, pasi me E. kanë hyrje dalje familjare, e derisa në banesën e prindërve të tij nuk kishte qenë një kohë të gjatë prej rreth dy muajsh, kanë hyrë, e pasi kanë qëndruar rreth 15 minuta, aty ka ardhur policia bashkë me vëllain e tij, T., i cili ka qenë poshtë te hyrja e banesës, e pastaj policia e kanë njoftuar se kanë ardhur për kontroll nën dyshimin se ka narkotik, pastaj kanë kontrolluar banesën dhe kanë gjetur disa substanca narkotike në dhomën e fjetjes së vëllait të tij, T. Po ashtu, i akuzuari Xh. ka thënë se atë natë në banesë policia e ka kontrolluar nëpër trup por nuk i kanë gjetur asgjë, ndërsa në dhomën ku është gjetur narkotiku fle vëllai i tij T.Xh. dhe se ai – L. nuk e ka ditur se në dhomën e T. ka pasur substanca narkotike, pasi ai ka dalë nga banesa e prindërve dhe ka më shumë se një vit që jeton në një banesë tjetër në të cilën bashkëjeton me Q.G.

Në pyetje nga prokurori i shtetit, i akuzuari L.Xh. ka thënë se është e vërtetë se nuk ka qenë në dijeni se në banesën e prindërve të tij ka substanca narkotike, ndërsa pasi prokurori i shtetit e ka ballafaquar të akuzuarin me deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 21.02.2024, faqe 3, ku ka thënë “unë policisë i kam treguar se posedoj 11 gram marihuanë, dy peshore për matje, që kur ta blej marihuanën për posedim personal ta kem me dije se çfarë peshe pe marr, po ashtu një mulli për bluarje të marihuanës, që tregon se e kam pasur për posedim personal si dhe letra që shërben për mbështjellje të marihuanës të cilat mi ka sekuestruar policia”, cila është e vërteta?, i akuzuari L.Xh. ka thënë se nuk do të përgjigjet në këtë pyetje. Po ashtu, prokurori i shtetit e ka ballafaquar të akuzuarin me vërtetimin për sekuestrimin e provave dhe pasurisë, të datës 02.02.2024 duke e pyetur të akuzuarin Xh. se a është nënshkrimi i tij në vërtetim, ndërsa i akuzuari Xh. ka pohuar se e ka nënshkruar këtë vërtetim sepse ka qenë nën presion dhe ndikim të policisë, të cilët janë munduar ta bindin se do të kaloj më lehtë, por gjërat e përshkruara në vërtetim nuk janë gjetur te ai, pasi i ka njoftuar se nuk jeton aty.

Në rimarrje në pyetje nga mbrojtësi i tij, i akuzuari Xh. ka thënë se atë natë policia ia ka paraqitur edhe procesverbalin mbi kontrollin e banesës dhe vërtetimin mbi sekuestrimin e sendeve, të cilët i ka nënshkruar duke u bazuar në procesverbal, dhe se gjatë marrjes në pyetje në prokurori nuk i është dhënë mundësia t’i shoh provat.

Në pyetje të KTGJ, i akuzuari Xh. është përgjigjur se kur është marrë në pyetje nga policia, avokati ka ardhur në përfundim të marrjes në pyetje.

Në pyetje nga ATGJ, i akuzuari L.Xh. ka thënë se në banesën ku bashkëjeton me të fejuarën e tij jeton që prej datës 01.07.2023 dhe për këtë posedon kontratë për qiranë.

Pas njoftimit me të drejtat e tij të parapara me nenin 344 të KPP, se ka të drejtë të mos deklarohet, e nëse zgjedh të deklarohet marrja e tij në pyetje do të zbatohet në pajtim me paragrafët 2 dhe 4 të këtij neni, i akuzuari E.H. ka shfrytëzuar të drejtën e tij për të deklaruar dhe në pyetje nga mbrojtësi i tij ka pohuar se thëniet e tij në prokurori me datë 21.02.2024 qëndrojnë në tërësi, duke shtuar se dy peshore digjitale dhe një mulli për të cilat akuzohet nga

prokuroria nuk janë të tij dhe se asnjëherë nuk ka shitur narkotikë, si dhe në kohën kur është ndaluar për këtë rast, ka qenë i punësuar dhe student në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, dhe se ky është rasti i parë që akuzohet nga prokuroria për narkotikë, duke shtuar se paratë që janë sekuestruar nga ai, kanë qenë kursimet e tij gjatë punës në Hotel P... dhe me ato para ka pasur për t'i paguar semestrat në fakultet.

Në pyetje nga prokurori i shtetit i akuzuari H. ka thënë se kur e kanë ndaluar policia, ka qenë në banesë të L. së bashku me L. , të cilin e njeh që nga fëmijëria dhe se arsyeja e takimit me L. në banesën e tij ka qenë se kanë qenë duke shkuar në një ndejë në B. në Villat A... me disa shokë tjerë, e ai – L. ka dashur ta bëj një dush. Pastaj, i akuzuari H. ka theksuar se kur e kanë ndaluar policia, ai ka pasur shtatë qese me marihuanë në xhep, për të cilat vet e ka njoftuar policinë, ndërsa shtatë qese dhe një qese frizi me 30 gram marihuanë i ka lëshuar në dollap të dhomës së L., duke shtuar se te ai – E. nuk janë gjetur peshore dixhitale e as mulli, ndërsa substancat në dollapin si më lart i ka lënë rreth pesë minuta para se të hyjë policia.

Në pyetje nga mbrojtësi i të akuzuarit L.Xh., i akuzuari ka pohuar se e njeh të miturin T. Xh., dhe ka raporte shoqërore me të.

I akuzuari Xh. ka thënë se nuk ka pyetje për të akuzuarin H., përveç vërejtjeve sa i përket thënieve të tij kur thotë dhoma e L.Xh., për të cilën ka thënë se nuk është dhoma e tij.

Në pyetje të KTGJ, i akuzuari H. është përgjigjur se T. Xh., mund të jetë rreth 16 vjeç dhe se nuk ka njohuri nëse dhomën ku fle T. Xh., e përdorë edhe i akuzuari L., por prindërit e L.Xh. jetojnë rregullisht në banesën ku është gjetur narkotiku.

Në fund të mbrojtjes së tij, i akuzuari H. ka thënë se substancën narkotike të gjetur te ai nga policia, e ka blerë me qëllim që ta përdorin me shoqëri në B. gjatë dy ditëve të qëndrimit atje, ndërsa narkotikët që janë gjetur në dollap siç e ka përshkruar më lart, i ka lënë nga paniku pasi nga ballkoni e ka parë 4-5 vetura të policisë, të cilët pastaj me T. Xh., janë ngjitur në banesë.

Aktgjykimi si më lart është bazuar vetëm në faktet dhe provat e proceduara në shqyrtim gjyqësor, siç parasheh dispozita e nenit 360 të KPP, e për të cilat do të jepet vlerësimi si në vijim:

Nga raporti informues për konfirmim të bastisjes me numër të rastit R-2024-XI-DKKO-HTN-PR-21 i datës 03.02.2024 nga Policia e Kosovës- DHTN-DKKO-Prishtinë, është vërtetuar se është kryer kontrolli i banesës së L.Xh.t;

Nga procesverbali për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm, me numër rasti R-2024-XI-DKKO-HTN-PR-21 të datës 02.02.2024 nga Policia e Kosovës- DHTN-DKKO-Prishtinë, është vërtetuar se gjatë kontrollit të banesës së L.Xh.t, i njëjti vullnetarisht ka pranuar se ka një armë, rreth 4 gram narkotik dhe një peshore, e sipas tij, pjesa tjetër e narkotikëve i përket tani të akuzuarit E.H., i cili është gjetur para derës së banesës së bashku me tani të akuzuarin Xh.;

Nga vërtetimet mbi sekuestrimin e provave apo të pasurisë me numër të rastit R-2024-XI-DKKO-HTN-PR-21 të datës 02.02.2024 nga Policia e Kosovës- DHTN-DKKO-Prishtinë, është vërtetuar se te të akuzuarit janë gjetur sasia e narkotikut të llojit marihuanë me peshë të përgjithshme prej 47.03 gram, një revole e tipit “Blow Mini Mod 2003” me dy fishekë, dy peshore digjitale dhe një mulli (grinder) për bluarjen e substancës narkotike;

Në fotoalbumin nga Njësia e Forenzikës lidhur me numrin e rastit me numër të rastit R-2024-XI-DKKO-HTN-PR-21 i datës 02.02.2024, shihen sendet e sekuestruara të paraqitura si më lart;

Nga raporti i ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me numër AKF/2024-0900/24 – 855, i datës 26.03.2024, është vërtetuar se sasia e narkotikut e sekuestruar është e llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 47.03 gram;

Nga raporti i ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me numër AKF/2024-1012/24 – 967, i datës 25.03.2024 është vërtetuar se pistoleta e gasit “Blow Mini Mod 2003” e kalibrit 8 mm, me numër serik 6-211761 ka qenë e dizajnuar për fishekë të kalibrit 8 mm me gas, mirëpo i është ri dizajnuar tyta, e në këtë mënyrë është bërë armë e zjarrit e kalibrit 6.35x15 mm dhe e njëjta është funksionale, e po ashtu edhe dy fishekë të kalibrit 6.35x15 mm janë përdorur për gjuajtje testuese dhe kanë qenë funksional, por nuk janë gjetur përputhshmëri me artikujt e librarisë së rasteve të hapura; dhe

Nga raporti i ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me numër AKF/2024-0098 i datës 26.03.2024, me të cilin nga telefoni i të pandehurit E.H. janë nxjerr disa fotografi në të cilat shihen substancat narkotike, të cilat përkojnë me përshkrimin e pikës I të aktakuzës, pasi te i akuzuari H. janë gjetur shtatë qese me substancë narkotike të llojit marihuanë.

Nga mbrojtja e të akuzuarit L.Xh. se në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 21.02.2024, faqe 3, ku ka thënë “unë policisë i kam treguar se posedoj 11 gram marihuanë, dy peshore për matje, që kur ta blej marihuanën për posedim personal ta kem me dije se çfarë peshe pe marr, po ashtu një mulli për bluarje të marihuanës, që tregon se e kam pasur për posedim personal si dhe letra që shërben për mbështjellje të marihuanës të cilat mi ka sekuestruar policia”, për të cilat thënie, në shqyrtim gjyqësor ka thënë se nuk do të përgjigjet, është vërtetuar se i akuzuari Xh. ka poseduar narkotikë dhe peshore për matjen e tyre.

Edhe nga mbrojtja e të akuzuarit E.H. është vërtetuar se ai ka pasur shtatë qese me marihuanë në xhep, për të cilat vet e ka njoftuar policinë, ndërsa shtatë qese dhe një qese frizi me 30 gram marihuanë i ka lëshuar në dollap të dhomës së tani të akuzuarit L.Xh. dhe se substancën narkotike të gjetur te ai nga policia, e ka blerë me qëllim që ta përdorin me shoqëri në B. gjatë dy ditëve të qëndrimit atje, ndërsa narkotikët që janë gjetur në dollap, i ka lënë nga paniku pasi nga ballkoni ka parë 4-5 vetura të policisë, të cilët pastaj me T. Xh., janë ngjitur në banesë, e me këto thënie të tij është vërtetuar se ai ka poseduar narkotikë.

Nga provat materiale të administruara si më lart dhe mbrojtja e të akuzuarve, është vërtetuar se te tani të akuzuarit si më lart policia ka gjetur narkotikun, dy peshore digjitale, një mulli grinder për bluarjen e substancës narkotike, si dhe armën, të përshkruara në dispozitivin e këtij aktgjykimi, për të cilën armë i akuzuari Xh. e ka pranuar fajësinë, por sipas këtyre provave nuk është vërtetuar se të akuzuarit e kanë poseduar narkotikun për shitblerje apo shpërndarje, pasi që, edhe dispozita e nenit 267 të KPRK është mjaft e qartë, pasi në të nuk parashihet se nëse kryesit të veprës penale i gjenden në posedim substanca narkotike me peshë më të madhe dhe pajisje për to siç janë letrat për mbështjellje, peshoret, mullinj apo pajisje tjera, i njëjti duhet akuzuar për shitje dhe shpërndarje, sepse nëse kemi të bëjmë me këtë duhet të gjenden personat të cilëve tani të akuzuarit si më lart iu kanë shitur apo shpërndarë substanca narkotike. As

dispozita e nenit 269 par. 1 të KPRK nuk parasheh ndonjë kusht te veçantë, përkatësisht kufizime në peshën e narkotikut.

Në dispozitivin e parë të aktakuzës, prokurori i shtetit në tërësi ka bërë përshkrimin e veprës penale të posedimit të paautorizuar të narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, por nuk ka përshkruar se kujt iu kanë shitur apo shpërndarë narkotikë tani të akuzuarit si më lart.

Kështu që, mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal janë interpretuar në favor të pandehurve dhe të drejtave të tyre. Kështu që, konform nenit 360, par. 2 të KPP, trupi gjykues ka vendosur ta bëjë rikualifikimin e veprës në dispozitivin e parë të aktakuzës, nga vepra penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK në veprën penale Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269, par. 1 të KPRK, pasi që sasia e narkotikut është gjetur te të akuzuarit, përkatësisht i akuzuari L.Xh., në prokurori me datë 21.02.2024 në prani të mbrojtësit të tij, ka pohuar se ka poseduar 11 gram marihuanë, dy peshore për matje, që kur ta blen marihuanën për posedim personal ta ketë me dije se çfarë peshe është duke e marrë, po ashtu një mulli për bluarje të marihuanës dhe letra që shërbejnë për mbështjelljen e saj. Edhe i akuzuari E.H., në prokurori me datë 21.02.2024 në prani të mbrojtësit të tij, ka pohuar se ka poseduar 30 gram marihuanë, ndërsa 14 qese me marihuanë me peshë prej 18.2 gram janë gjetur në dhomën e të akuzuarit L.Xh. e të cilat i kanë poseduar për përdorim personal. Në mungesë të dëshmive personale, përkatësisht blerësve të mundshëm apo personave të cilëve ka mundur tu shpërndahet substance narkotike, trupi gjykues ka vlerësuar dhe ka ardhur në përfundimin se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shitblerje apo shpërndaje të paautorizuar të narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267, par. 1 të KPRK, andaj edhe ka vendosur për rikualifikimin e veprës penale nga shitja po shpërndarja në veprën penale posedimi i këtyre substancave.

Duke u bazuar në dispozitën e nenit 360 të KPP, gjykata e ka bazuar aktgjykimin në provat materiale të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në mbrojtjen e të akuzuarve.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që, ndaj të akuzuarve, gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese siç janë: sjellja e tyre para dhe pas kryerjes së veprës penale, pasi që për të njëjtit sipas evidencës së kësaj gjykate, nuk ka ndonjë aktgjykim të formës së prerë se janë dënuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale dhe moshën e tyre relativisht të re në kohën e kryerjes së veprës penale, përkatësisht të njëjtit janë 21 vjeç, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka marrë parasysh shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarve në kryerjen e veprave penale dhe intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, sepse me vënien përdorimin e narkotikëve të rrezikshëm rrezikohet shëndeti dhe jeta e qytetarëve të cilët konsumojnë këto substanca.

Andaj, gjykata të akuzuarve iu shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale për të cilat janë shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe se me dënimin e shqiptuar atyre do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi që të akuzuarve t'iu konfiskohen substancat narkotike, një revole "Blow Mini Mod 2003" me dy fishekë, dy peshore digjitale dhe një mulli grinder për bluarjen e substancës narkotike, të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si sende të përdorura për kryerjen e veprave penale, u mor në bazë të neneve 269, par. 3 dhe 366 par. 3 të KPRK.

Gjykata ka vendosur që të akuzuarit L.Xh. t'i kthehen paratë e gatshme në vlerë prej 710 euro, ndërsa të akuzuarit E.H. t'i kthehen paratë e gatshme në vlerë prej 340 euro dhe telefoni i tipit Iphone 14 Pro Max, pasi nuk është vërtetuar se janë përdorur për kryerjen e veprës penale apo përfituar me kryerjen e veprës penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 452, par. 1 të KPP, ndërsa vendimi mbi taksën për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të neneve: 3; 6 dhe 39, par .3.2 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të neneve 269 par. 1 dhe 3; 366 par. 1 dhe 3 të KPRK, si dhe nenit 364 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 16.10.2024.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.91/2024, datë 10.10.2024.

Bashkëpunëtore profesionale
Arbenita Hoxha Koleci

Kryetari i trupit gjykues
Naser Foniqi

UDHËZIMI PËR MJETET JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar **brenda tridhjetë (30) ditësh**, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.